



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2021:077447

Datë: 05.07.2021

Numri i dokumentit: 01957863

PKR.nr.118/2021

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti për Krime të Rënda, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Behar Ymeri, me sekretaren juridike Fatmire Sermaxhaj, në çështjen penale ndaj të pandehurit R. Sh., me vendbanim në fshatin S. K. Kamenicë, mbrojtësi i tij avokati Ymer Huruglica, me autorizim në shkresa të lëndës, për shkak të veprës penale Sulmi seksual nga neni 229 paragrafi 3 nën paragrafi 3.7 lidhur me paragrafin 1, 5 dhe 7 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjilan-Departamenti për Krime të Rënda PP.I.79/2021 të datës 16.06.2021, të cilën e përfaqëson prokurori Isuf Sadiku, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, më datën 02.07.2021, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri R. Sh., i biri i S. Sh. dhe nënës S. Sh., e gjinisë M., i lindur më 19.10.1965, në fsh. Strezoc K. e Kamenicës, ku edhe jeton, me numër personal me numër të telefonit 044/...-..., ka të kryer shkollën e mesme, me profesion zyrtar policor, i gjendjes së mesme ekonomike, i martuar - baba i katër fëmijëve, shqiptar, shtetas i R. të Kosovës, më parë i pa dënuar dhe nuk udhëhiqet procedurë tjetër penale ndaj tij nën masën e paraburgimit nga dt.21.04.2021.

ËSHTË FAJTOR

Sepse në periudhën kohore nga muaji nëntor i vitit 2020 e deri më datë 20.04.2021 në Kamenicë i pandehuri ka prekur personin tjetër me qëllim seksual, pa pëlqimin e personit ashtu që i pandehuri ka takuar disa herë në banesën e familjes tani të dëmtuarës –fëmijës viktimë me aftësi të kufizuara mendore D. K. e lindur me 20.01.2006 dhe me këtë rast ndaj të njejtës ka ushtruar sulm seksual dhe ate duke e puthur viktimën në fytyrë, në buzë, në pjesën e gjoksit, pastaj duke e përçafuar si dhe prek në zonat intime dhe që këto veprime i ka përsëritur në intervale të ndryshme kohore.

me çka ka kryer veprën Sulmi seksual nga neni 229 paragrafi 3 nën paragrafi 3.7 lidhur me paragrafin 1, 5 dhe 7 të KPRK-s.

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore dhe neneve 4, 38, 42, 63, 69, 70, 71, 72 dhe 79 të KPRK, si dhe nenit 365 dhe 367 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), të pandehurin.

E G J Y K O N

I. Të pandehurit **R. Sh.**, për veprën Sulmi seksual nga neni 229 paragrafi 3 nën paragrafi 3.7 lidhur me paragrafin 1, 5 dhe 7 të KPRK-s i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjastë) vite, i cili dënimi do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

II. Në bazë të nenit 63 paragrafi 5 të KPRK-s dhe nenit 116 të Kodit të Drejtësisë për të mitur të pandehurit R. Sh. i shqiptohet Denimi plotësues Ndalimi i ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej 3 (tre) vite pas plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, koha e kaluar në burg nuk llogaritet në kohëzgjatjen e këtij dënimi.

III. Në bazë të nenit 367 të KPPRK-s, të pandehurit R. Sh. i vazhdohet masa e paraburgimit derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë por jo më shumë se denimi i shqiptuar.

IV. Në bazë të nenit 79 të KPRK-s, të pandehurit R. Sh. koha e kaluar në paraburgim nga data 21.04.2021 do të llogaritet në dënimin e shqiptuar.

V. Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

VI. Obligohet i pandehuri që të paguaj taksën për Kompensimin e Viktimave të krimit në shumën prej 50.00 € (pesëdhjetë euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm

VII. Obligohet i pandehuri që të paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej 50.00 € (pesëdhjetë euro) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm.

A R S Y E T I M

1. Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare e palëve

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti për Krime të Rënda, me datë 16.06.2021, ka ngritur aktakuzën PP.I.79/2021, kundër të pandehurit R. Sh., me vendbanim në fshatin S. K. Kamenicë, për shkak të veprës penale Sulmi seksual nga neni 229 paragrafi 3 nën paragrafi 3.7 lidhur me paragrafin 1, 5 dhe 7 të KPRK-s.

Në shqyrtimin fillestar dhe publik të datës 02.07.2021 prezent ishin prokurori i shtetit Isuf Sadiku, i pandehuri R. Sh. dhe mbrojtësi i tij avokati Ymer Huruglica,, mbrojtësi i viktimave Gani Leci, përfaqësuesja e QPS në Kamenicë Kimete Kryeziu, përfaqësuesja ligjore e të dëmtuarës Rafete Kosumi dhe përfaqësuesi i të dëmtuarës, av. Enver Ajvazi, ku i pandehuri pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit ka deklaruar se e pranon fajsinë për kryerjen e veprës penale sipas dispozitivit të aktakuzës.

2. Vlerësimi i pranimin të fajësisë

Në shqyrtimin fillestar dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurorit të shtetit, përfaqësueses ligjor të dëmtuarës, mbrojtësit të viktimave dhe mbrojtësit, përfaqësueses me autorizim të dëmtuarës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit R. Sh. për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar as i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj veprë penale, ekziston fakti se i pandehuri R. Sh., ka kryer veprën penale Sulmi seksual nga neni 229 paragrafi 3 nën paragrafi 3.7 lidhur me paragrafin 1, 5 dhe 7 të KPRK-s, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve lidhur me dënimin, ka shpallur fajtor të akuzuarin R. Sh., për shkak të veprës penale Sulmi seksual nga neni 229 paragrafi 3 nën paragrafi 3.7 lidhur me paragrafin 1, 5 dhe 7 të KPRK-s. Ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqiptimit të dënimit duke u bazuar në nenit 69,70,71 dhe 72 paragrafi 1 duke e zbatuar në mënyrë të përshtatshme nën paragrafin 1.1 të KPRK-s, ka vlerësuar se duhet të pranohet pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe të njëjtit ti shqiptohet dënim me burg si në dispozitiv, ngase duke i marrë parasysht të gjitha rrethanat dhe provat ky dënim do të jetë dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale, ashtu që për të akuzuarin R. Sh. si rrethanë lehtësuese ka marrë faktin se i akuzuari në të gjitha fazat e procedurës e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, Përfaqësuesja ligjore e palës së dëmtuar nuk i është bashkangjitur ndjekjes penal ndaj të pandehurit, i pandehuri më parë nuk ka kryer vepra penale dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla dhe të tjera penale, dhe se i njëjti është penduar, i ka kërkuar falje të dëmtuarës dhe familjes së saj, ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori mënyrën e kryerjes së veprës penale, moshën e viktimës së mitur, gjendjen mendore dhe se e dëmtuara është viktimë e ndishme.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Sipas bindjes së gjyqtarit të vetëm gjykues dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit R. Sh. duke marrë parasysht rrethanat e përmendura më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit.

Gjyqtari po ashtu ka konstatuar se me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-s, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Vendimi mbi vazhdimin e paraburgimit

Në bazë të nenit 367 të KPRK-s, të pandehurit R. Sh. i është vazhduar masa e paraburgimit derisa aktgjykimi të bëhet i formës së prerë por jo më shumë se dënimi i shqiptuar.

8. Vendimi mbi llogaritjen paraburgimit

Në bazë të nenit 79 të KPRK-s, të pandehurit R. Sh. koha e kaluar në paraburgim nga data 21.04.2021 i është llogaritur në dënimin e shqiptuar.

9. Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike

Pala e dëmtuar për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest civil.

10. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale dhe gjendjen financiare e të pandehurit, gjykata, duke u bazuar nën 453 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin ta detyrojë për të paguar kompensimin për viktimat e krimit dhe shpenzimet e procedurës penale, si dhe paushallin gjyqësor në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
PKR.nr.118/2021, Me datë 02.07.2021

Sek. Juridike
Fatmire Sermaxhaj d.v

Gjyqtari
Behar Ymeri d.v

KËSHILLA JURIDIKE;Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit PËR Krime të Rënda në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.